

Abstrakti

Ky punim diplome tregon se sa kjo procedurë është e rëndësishme për të kuptuar se si funksionon demokracia në praktikë dhe si institucionet qeveritare përballen me sfida të tilla si mosbesimi ndaj qeverisë. Përmes këtij punimi sqarohet shumëçka lidhur me rregullimin kushtetues të mocionit të mosbesimit në Kosovë, Shqipëri dhe Gjermani.

Objektivat e këtij hulumtimi janë mjaft të qarta, pasi që jam munduar t'i zbulojë mangësitë e rregullimit në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, lidhur me institutin e mocionit të votëbesimit dhe mosbesimit të Qeverisë. Aspekt tjetër i këtij studimi është krahasimi me kushtetutën e Shqipërisë dhe Gjermanisë, të cilat kanë një rregullim më të detajizuar të mocionit të votëbesimit dhe mosbesimit ndaj qeverisë. Më tej, këtë studim e kam analizuar duke u bazuar edhe në rastet e praktikës parlamentare në Kosovë, Shqipëri dhe Gjermani.